

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjykatëses Luljete Shabani, me sekretaren juridike Hikmete Veliu-Pajaziti, në lëndën penale ndaj të akuzuarit S.A nga fsh. B, për shkak të veprës penale Sulmi, nga neni 187, par.3, lidhur me par. 2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i përgjithshëm PP.nr. 643/2014, të datës 19.05.2014, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 06.05.2016, mori dhe publikisht shpalli këtë :

A K T G J Y K I M

I akuzuari S. A, nga babai M dhe nëna Xh, e lindur S, i lindur më datë ..në fsh. B ku edhe jeton, i martuar, baba i dy fëmijëve, i papunë, ka te kryer shkollën fillore, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës , andaj,

në pajtim me nenin 364 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të Kodit të Procedurës Penale (KPPRK),

LIROHET NGA AKTAKUZA

Sepse, nuk ka prova se e ka kryer veprën penale Sulmi, nga neni 187, par.3, lidhur me par.2 të KPRK, sipas aktakuzës PP. nr. 643/2014, të datës 19.05.2014,

Se gjoja më datën 18.03.2014, rreth orës 06.40 min., në shtëpinë e tyre të përbashkët, në fsh. B, për shkak të raporteve jo të mira dhe mosmarrëveshjeve të vazhdueshme familjare, e ka sulmuar të dëmtuarën-bashkëshorten e tij, , në atë mënyrë që , pasi fillimisht janë ëfjalosur mes vete, duke e përdorë forcën, ek a goditur me grushte në pjesën e gojës dhe në pjesën e poshtme të syrit, si dhe me mjet të përshtatshëm për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor, me sopatë e ka goditur mbrapa në kokë,

*- me çka do të kishte kryer vepër penale **Sulmi**, nga neni 187, par. 3, lidhur me par.2 të KPRK-së.*

Pala e dëmtuar, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil. Shpenzimet e procedurës penale, paguhen nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur aktakuzën e lartcekur, PP. II. nr. 643/2014, të dt. 19.05.2016, ndaj të akuzuarit , për shkak të veprës penale, Sulmi, nga neni 187, par.3, lidhur me par.2 të KPRK-së

Në shqyrtimin fundit gjyqësor dhe publik, të mbajtur më datën 28.04.2016, prokurorja Kujtesa Fazliu, deklaroi se padyshim se në seancat e deri tanishme gjyqësore, është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe bindëse teza e aktakuzës, dhe ate, duke filluar nga shtjellimi dhe

analizimi i provave materiale, si ato në shkresat e lëndës, ashtu edhe ato të shqyrtuara gjatë seancave gjyqësore, gjithashtu edhe nga dëgjimi i dëshmitares dhe të dëmtuarës në cilësi të dëshmitares si dhe vet i pandehuri, nga të cilat vihet në përfundim se padyshim është kryer vepra penale që kjo aktakuzë ia vë në barrë, andaj, kërkojmë nga gjykata që me rastin e shqiptimit të dënimit të marrë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese, edhe ato rënduese.

I akuzuari, si në fillim të procedurës, po ashtu edhe në fund, deklaroi se ai nuk e ka kryer këtë vepër penale

E dëmtuara në cilësi të dëshmitares, , deklaroi se në ditën kritike ka pasur mosmarrëveshje me të akuzuarin, bashkëshortin e saj, Stojanin, për shkak se kur kjo ka dashur të marrë dru për ta dhezur shporetin, ai nuk e ka lejuar, duke i thënë se drutë janë të tij, pastaj, e ka goditur me duar në pjesë të ndryshme të trupit, por, nuk i kujtohet se në cilat pjesë, ndërsa, me sëpate e ka goditur në pjesën e mbrapme të kokës, për çka, kjo ka pasur ënjtje të kokës, e jo gjakderdhje, por, nuk ka shkuar te mjeku. Ajo tha se jetojnë bashkë në një shtëpi me Stojanin, por, nuk flejnë bashkë, meqë ai nuk e meriton, ndërsa, edhe më parë kanë pasur probleme, e edhe pas këtij rasti, për çka mendon se ai ka nevojë për psikiatër dhe kjo është e gatshme të pajtohet me te.

Dëshmitarja e propozuar në aktakuzë, D.S, zyrtare policore në, deklaroi se në ditën kur është paraqitur rasti në polici, për të ka qenë dita e parë e punës në Partesh dhe tha se nuk ka shkuar në vend të ngjarjes, por, vetëm ua ka marrë deklaratat të dy palëve, të cilët e kanë akuzuar njëri tjetrin dhe e kanë njoftuar se vazhdimisht kanë pasur por, kur kjo i ka kërkuar raport mjekësor të dëmtuarës, ajo ka deklaruar se nuk ka, ndërsa, kjo nuk e ka vërejtur ndonjë lëndim tek ajo, edhe pse ajo është ankuar për kokë dhembje. Ajo shtoi se e di se këta vazhdimisht kanë probleme, e herë deklarojnë se jetojnë bashkë, e herë se nuk jetojnë bashkë, ndërsa, i akuzuari deklaroi se e dëmtuara shkon vazhdimisht nëpër restorante dhe kthehet në shtëpi kah mëngjesi dhe mendon se kjo sjellë probleme.

I akuzuari S.A, me rastin e marrjes në pyetje, deklaroi se nuk është e vërtetë se ai në ditën e cekur e ka sulmuar, e as shtyer të dëmtuarën dhe nuk di se pse në prokurori ka deklaruar se e ka shtyer të dëmtuarën. Ai tha se me të dëmtuarën, vazhdimisht kanë probleme, sepse, ajo nuk e respekton dhe kjo ka filluar prej para tri vjetësh, kur vajza e tyre është martuar në fsh. Shdhe vjehri i saj, ka qëndruar shumë në shtëpinë e tij dhe është shëtitur me të dëmtuarën D, gjë që këtë e ka penguar. Ai tha se me D jetojnë bashkë në një shtëpi, por, në dhoma të ndara, pasi nuk kanë marrëdhënie bashkëshortore dhe kjo nuk është hera e parë që ajo e ka lajmëruar këtë në polici, por, edhe ky ka pasur raste kur e ka lajmëruar ate, ndërsa, kjo është hera e katërt që ata kanë raste në gjykatë. Në fund, ai shtoi se është i gatshëm të pajtohet me të dëmtuarën deh të fillojnë jetën e përbashkët, por, ajo edhe pse në gjykatë ka deklaruar se është e gatshme të pajtohet, në shtëpi flet ndryshe.

Pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, pas dëgjimit të të dëmtuarës në cilësi të dëshmitares, D. A, dëshmitares D .N .dhe vet të akuzuarit, gjykatësja, erdhi në përfundim se me asnjë provë nuk e është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale që i vihet në barrë, meqë, edhe pse e dëmtuara ka deklaruar se i akuzuari e ka goditur, këtë nuk ka mundur ta argumentojë, pasi që nuk ka sjellë si provë asnjë raport mjekësor, ndërsa, dëshmitarja D. N. zyrtare policore, ka deklaruar se nuk ka vërejtur ndonjë lëndim tek e dëmtuara, edhe pse ajo është ankuar për dhembje koke dhe kur kjo i ka kërkuar raport mjekësor, ajo nuk ka pasur.

Duke i analizuar të gjitha provat një nga një, duke u bazuar në nenet 260, par. 2 dhe 3, si dhe par 1, 1, nën par. 1.3 të nenit 364 të KPPRK-së si dhe të gjitha shkresave të lartë cekura dhe erdhi në përfundim se me asnjë provë nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, andaj, e liroi nga përgjegjësia penale, në bazë të nenit 364, par.1, nënpar.1.3 të KPPRK-së, nga se mungojnë provat materiale mbi të cilat prokuroria do ta kishte bazuar aktakuzën.

Në bazë të nenit 454 të KPPRK-së Gjykata vendosi që shpenzimet e procedurës penale të bien në barrë të kësaj gjykate .

Në pajtim me nenin 463 të KPPRK-së pala e dëmtuar udhëzohet në kontest civil .

Duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, gjyqtari vetëm gjykues ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i përgjithshëm
më 06.05.2016

Sekretarja juridike,
Hikmete Veliu-Pajaziti

Gjykatësja e vetme gjykuese,
Luljete Shabani

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njejtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.

